



Npi – 01/391 datë: 28.11.2022

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 28.11.2022, është nxjerrë ky:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -XI- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES**  
E mbajtur më: 28.11.2022, (e hënë) në ora 9.<sup>00</sup> h. në Vlorë në sallën e konferencave “Hotel Kraal”.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi i Kuvendit: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Kuvendit: z.Përparim Ramusa, z.Adem Ramadani, z.Hasan Avdyli, z.Hamëz Tërshani, z.Besnik Seferi, z.Gëzim Haxhiu, z.Reshat Mujota, z.Asllan Beqaj, znj.Shkurte Mustafa, znj.Sanije Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Kadri Emimi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj dhe z.Rexhep Gashi.

Në mbledhje përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Drejtorët: DKA, z.Lulzim Sahiti), (DZHE, z.Kastriot Shabani), (DAP, z.Valon Januzi), (DPUKGJ, z.Grejtalb Emimi), nga (ZKF-ja z.Bujar Ferati), Nga (Zyra për Komunitete, z.Ibrahim Demiri), dhe z.Shqiprim Hyseni, praktikant.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konststoj, Kuotumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

**Pjesa e mbledhjes Solemne të Kuvendit**

1. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës, për festën Kombëtare, 28 Nëntori 1912,

**Pjesa e mbledhjes së rregullt të Kuvendit**

1. Dhënia e betimit të znj.Zejnije Veliut, (Pikë Shtesë)
2. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.10.2022,
3. Draft-Rregullore për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes, (pas diskutimit publik)
4. Draft-Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik)
5. Propozim-Vendim për transfer dhe rialokim të ndarjeve buxhetore të shpenzimeve Komunale për vitin 2022,
6. Draft-Plani i Punës i Grupit Jo-Formal të Grave për vitin 2023,
7. Informatë nga DPUKGJ për Implementimin e Projekteve Kapitale ne Komunën e Shtimes.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimi për rendin e ditës. Po e hapi këtë mbledhje duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit këtu në Shqipëri, për herë të parë po e mbajmë këtë mbledhje me

rastin e festës Kombëtare 28.11.2022. në vazhdim po e prezantoj rendin e ditës. Fillimisht po ceku se kemi edhe një zëvendësim të një anëtare të Kuvendit, ku duhet ta fusim si pikë shtesë të rendit të ditës edhe betimin e anëtares së re të Kuvendit znj.Zejnije Veliu.

**z.Përparim Ramusa;** Përshëndetje, i urojë fat anëtares së re të Kuvendit, pajtohemi me rendin e ditës dhe me propozimin tuaj Kryesues për pikën shtesë. Gjithashtu propozojë që pika 7 (Informatë nga DZHE - Sektori i Bujqësisë (me theks të veçantë subvencionet), të shtyhet për mbledhjen e radhës.

**z.Kadri Emini;** Përshëndetje. Urime për anëtares e re. Sa i përket pikës 7 (Informatë nga DZHE - Sektori i Bujqësisë (me theks të veçantë subvencionet) për shtyrje, drejtori ka ardhur pikërisht për këtë arsye në Shqipëri, unë jam “për” që kjo pikë ë rendit të ditës të mbetet ne këtë mbledhje.

**z.Reshat Mujota;** Urime festa e Flamurit, urime ditëlindja e Komandantit Adem Jashari, dhe dalja haptazi e UÇK-së në opinion. Kam pas një kërkesë, por për shkak të betimit të anëtares së re të Kuvendit nuk e kam bërë. Unë kërkojë që Zejnije Veliu të na tregoj se a betohet si anëtare e VV-së, apo e listës Guxo.

**z.Besnik Seferi;** Përshëndetje, pajtona me rendin e ditës. Sa i përket pikës 7 (Informatë nga DZHE - Sektori i Bujqësisë (me theks të veçantë subvencionet) mendoj se duhet të kryhet, sepse drejtori ka ardhur pikërisht për këtë.

**z.Rexhep Gashi;** Përshëndetje, urojë festën flamurit dhe Betimin e znj.Zejnije Veliut. Në këtë mbledhje duhet të kalojnë të gjitha pikat. Unë mendoj se duhet të shtyhet pika 7, sepse raporti i dërguar te ne nga drejtori është i mangët. Mirëpo për sa do ti kryejmë të gjitha pikat, është çështje e jona ndërsa te DZHE-ja duhet ta shtyjme raportin për shkak të pyetjeve dhe përgjigjeve.

**z.Reshat Mujota;** Nuk e shoh ndonjë problem edhe nëse shtyhet por edhe nëse prezantohet, ne mundemi me dëgjuar dhe me kërkuar mirëkuptim, kështu edhe po presim me shkua e me festua. Nëse drejtori është dakord me shty le ta shtyjme. Propozoj që kjo pik të jetë Nr. 8 në këtë rend dite.

**z.Besnik Seferi;** duhet ta kemi parasysh fjalorin që e përdorim, sepse duhet të jemi pak më sensibil.

**z.Hamëz Tërshani;** Urime festa e flamurit, dhe urime koleges Zejnije betimin. Ne po e bëjmë të kundërtën e asaj që kemi thënë, për përshpejtimin e kësaj mbledhje. Do të dalim pak edhe te festa.

**z.Përparim Ramusa;** Konsideroj se kjo mbledhje është më shumë festive e shtetit tonë. Ne u morëm vesh me shty këtë pikën 7, dhe kemi kërkuar me shkua me festua. Unë po e shoh që shumica janë më shty kështu që le të kalojë mbledhja në mënyrë festive.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë nuk jam për procedura të përshpejtuara, unë me Kryetarin e kemi formuluar rendin e ditës, dhe do ta qes në votim, e pastaj edhe propozimet e juaja nëse ka.

**z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE;** Përshëndetje, edhe unë jam i pajtimit se mund të shtyhet, mua nuk më prish punë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Unë do ta hedh në votim.

**z.Përparim Ramusa;** Propozojë që të hiqet nga rendi ditës pika 7 (Informatë nga DZHE - Sektori i Bujqësisë (me theks të veçantë subvencionet), të futet si pikë e rendit të ditës për këtë mbledhje pika shtesë: Betimi i Zejnije Veliu.

**\* Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi rendin e ditës me pikën shtesë Betimi i znj.Zejnije Veliu dhe që pika 7 (Informatë nga DZHE - Sektori i Bujqësisë (me theks të veçantë subvencionet), të shtyhet për mbledhjen tjetër.**

### Pjesa e mbledhjes Solemne të Kuvendit

#### Pika 1

#### Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës, për festën Kombëtare, 28 Nëntori 1912

Kryetari, z.Qemajl Aliu, me video mesazh mbajti një fjalë rasti për ditën e pavarësisë me datën 28.11.2022, prej disa minutash, duke uruar festën Kombëtare të popullit Shqiptar. Në vazhdim fjalimi i plot i Kryetarit z.Qemajl Aliu: “Të nderuar Anëtarë të Kuvendit, i nderuar Kryesues z.Adnan Ademi, i nderuari Bashkëpunëtor i Kuvendit z.Idajet Rexhepi, të nderuar drejtor e bashkëpunëtor që gjendeni

sot në këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës së Shtimes e cila po mbahet në qytetin e Vlorës, në një atmosferë festive, unë në pamundësi për të qenë fizikisht atje së bashku me ju, në këtë ditë të madhe, ju uroj gëzuar Festën e Pavarësisë së Shqipërisë, festën e 28 nëntorit, festën e pavarësisë së shtetit tonë Kombëtar Shqiptarë, 28 nëntorin e besëlidhjes të Skënderbeut, 28 nëntorin e Ismajl Qemajlit, 28 nëntorin e ditëlindjes të Komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jashari, 28 nëntorin e daljes hapur për herë të parë para popullit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 28 nëntorin e shumëfishtë fal të cilit ne sot jetojmë dhe gëzojmë lirin dhe Shtetin Shqiptar Kombëtar por edhe shtetin e Republikës së Kosovës. Ju uroj një seancë festive, sa më festive sa ma të këndshme, punë të mbarë, atje dhe të na rroj Shqipëria siç thonë andej në Vlorë, dhe shteti Shqiptar u bëftë ashtu siç e kam mendua dhe ashtu siç e kanë përjetuar të gjithë ata që përmendën që nga nëntori i Besëlidhjes së Skënderbeut deri tek gjaku i derdhur për liri i Dëshmorëve të Kombit, Martirëve dhe Invalidëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gëzuar edhe mirë u pafshim në Shtime.

#### Pjesa e mbledhjes së rregullt të Kuvendit

##### Pika 1 (shtesë)

##### Dhënia e betimit të znj.Zejnije Veliut

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** E ftoj znj.Zejnije Veliun, që të ngritët në këmbë dhe të lexoi me zë deklaratën solemne para Kuvendit duke e shqiptuar në fund fjalën “Betohem”.

**znj.Zejnije Veliu;** U ngrit në këmbë dhe lexoi Deklaratën Solemne, duke thënë në fund “Betohem”.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj se znj.Zejnije Veliu, e dha Betimin para Kuvendit të Komunës së Shtimes, me çka edhe formalisht u bë anëtare e re e Kuvendit të Komunës së Shtimes, me të drejta të plota ligjore por edhe me obligimet që bart ky post, i deleguar me vota nga qytetarët e Komunës tonë. znj.Zejnije Veliu e ka zëvendësuar me vendim të KQZ-së Nr.01-1443-2022, znj.Heroina Selmanin e cila vullnetarisht ka dhënë dorëheqje, nga ky post.

##### Pika 2

##### Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.10.2022

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimi për këtë pikë.

**\* Kuvendi i Komunës, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja më 31.10.2022.**

##### Pika 3

##### Draft-Rregullore për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në komunën e Shtimes, (pas diskutimit publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimi për këtë pikë.

**\*Kuvendi Komunës së Shtimes, me 15 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi Rregulloren për organizimin, funksionimin, dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanime, dhe lagje urbane, në Komunën e Shtimes.**

##### Pika 4

##### Draft-Strategjia për komunikim dhe marrëdhënie me publikun për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimi për këtë pikë.

**z.Ibrahim Demiri;** Përshëndetje, ne kemi përpiluar dokumentin si grup i punës, dhe kemi respektuar rregullat por edhe vendimin e Kuvendit për ta nxjerrë në diskutim publik, këtë draft-strategji. Takimi me qytetarë është mbajtur më 08.11.2022 në ora 14:00h kanë marrë pjesë një numër i vogël pjesëmarrësish, ku draft-strategjinë e prezantoi Kryesuesja e Komisionit znj.Anita Kurti. Diskutuan, z.Miftar Miftari, z.Ekrem Reqica, dhe znj.Zhaneta Demiri. Dokumenti është përgatitur mjaft mirë dhe ju ftoj si Kuvend që ta aprovoni.

**\*Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimsisht miratoi Strategjinë për komunikim dhe marrëdhënie me publikun në Komunën e Shtimes për periudhën 2023-2025.**

#### Pika 5

##### Propozim-Vendim për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore të shpenzimeve Komunale për vitin 2022

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** E njoftoi Kuvendin me rekomandimin e KPF-së dhe në vazhdim fjalën ja dha z.Bujar Feratit, për prezantimin kësaj pike.

**z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar;** Përshëndetje, prezantoi këtë pikë në pikat kryesore, materialin e keni marrë , dhe e keni lexuar. Nëse ka pyetje urdhëroni. (shih dokumentin)

**z.Përparim Ramusa;** Mendoj se ky rialokim është i nevojshëm dhe i arsyeshëm, propozoj ta votojmë sipas rekomandimit të KPF-së. Urojë, znj.Zejnije Veliun për mandatin e ri në Kuvend.

**z.Rexhep Gashi;** Edhe unë e urojë znj.Zejnije Veliun. Unë mendojë që këtu kemi shumë për të diskutuar, dhe mendoj se është jetike. Këtu kemi një keq-menaxhim dhe keq-planifikim, për këtë duhet dikush të jep përgjegjësi.

**z.Reshat Mujota;** Unë pe propozojë që të kryhet ky transferim. Pastaj me keq-menaxhim, pa destinimin e mjeteve nuk mund ta ndryshojmë.

**z.Muhamet Ademaj;** Urime festa e nëntorit. Suksese znj.Zejnije Veliut në punën e ardhshme. Unë e përkrahu këtë pikë që ta miratojmë sipas rekomandimit të KPF-së.

**\*Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimsisht miratoi Vendimin për Rialokimin dhe Transferimin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve Komunale për vitin 2022.**

#### Pika 6

##### Draft-Plani i punës i grupit Jo-Formal të Grave për vitin 2023

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** E kemi një draft-plan të Grupit Jo-Formal të Grave për vitin 2023, për herë të parë, dhe e kemi një rekomandim në KPF-së, që këtë grupi ti shtohet numri i grave edhe nga Komitetet jo shumicë. E hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Kuvendi Komunës së Shtimes, unanimsisht miratoi Planin e Punës të Grupit Jo-Formal të Grave në Komunën e Shtimes.**

#### Pika 7

##### Informatë nga DPUKGJ për Implementimin e Projekteve Kapitale ne Komunën e Shtimes

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja kaloj drejtorit të DPUKGJ-së z.Grejtalb Emini.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Përshëndetje, urime festa e Nëntorit. Unë menaxhoj me 45 projekte të vitit 2022. Sfidë e kisha përmendur inflacioni që ka krijuar probleme me operatorët Ekonomik. Unë nuk do ta kisha zgjatur shumë prezantimin meqenëse është atmosferë feste. Materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar kështu që nëse ka ndonjë pyetje, do të përgjigjem.

**z.Përparim Ramusa;** Faleminderit për informatën, unë nuk po dua me bë pyetje e as debat, por me 31 dhjetor do të debatojmë për secilin projekt.

**z.Muhamet Ademaj;** Faleminderit për informatën. Kërkojë që buxheti të shpenzohet tërësisht deri në përfundim të vitit. Unë ju uroj sukses edhe për vitet tjera.

**z.Rexhep Gashi;** Faleminderit për informatën. Vërtet po bëhet një punë e mirë, që për çdo punë që bëhet, unë kërkojë që menaxherët të dalin dhe të kontrollojnë punën e projekteve, sepse kemi një provoj të keqe lidhur me realizimin e projekteve, ato janë bërë edhe me nga dy tri herë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** E di që po pritni që sa ma parë më dal në festë, prandaj ju kisha lut që të jemi sa më të shkurt dhe efikas

**z.Reshat Mujota;** Urime Rexhë, për asfaltimin që është bërë te ti, e mos u bënë më me lloq. Faleminderit për informatën, tani po na vjen një informatë ku tregon që në secilën fushë kemi zvogëlim të investimeve. Ndërkaq atje te raporti keni thënë fjalë të mira. Te punët në teren nuk bënë me shtruar asfalt nëpër oborre.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Unë thash se arsyeja e zvogëlimit të projekteve është rritja e inflacionit dhe këtë ne nuk kemi mundur me ditur. Kemi rrugë të pa kategorizuara e të pa emërtuara të cilat duhet të asfaltohen, por unë nuk asfaltoj rrugë në pronë private. Nëse këto rrugë duhet me i asfaltuar atëherë ne duhet ta kemi deklaratën e palës se nuk kërkon shpronësim.

**z.Reshat Mujota;** Unë mendoj që nuk është e mjaftueshme që vetëm mos me kërkuar shpronësim, por unë po them që mos me hy nëpër oborre e me shtruar asfalt.

**z.Muhamet Ademaj;** Ne kemi vendosur me vendim për disa shpronësime, por ende nuk ka lëvizje për pagesat e këtyre shpronësimeve.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 10:14h.

Procesmbajtësi:  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit  
Adnan Ademi

